


GJYKATA SUPREME E KOSOVËS

AA .nr. 24/17

Më 17-10-2017
Prishtinë



PZAP - Prishtinë

Pranë kësaj Gjykate

LEVIZJA VETËVENDOSJE
PRISHTINË

ka ushtruar ankesë kundër vendimit


PZAP. A-171/17

Në përputhje me nenin 37 . 1 të Ligjit për Konflikte Administrative, ju dërgojmë një ekzemplar të padisë që të jepni përgjigje ndaj padisë dhe kërkojmë të na i dërgoni shkreat e lëndës që të mund të vendosim përkitazi me padinë.



Gjyqtari,

GJYKATËS SUPREME TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS



Nga: Lëvizja Vetëvendosje, rruga, Ekrem Rexha, Prishtinë

Kundër: Vendimit ZL.Anr 171/2017, të PZAP-së

Në bazë të nenit 118 par, 4 të Ligjit Për Zgjedhjet e Përgjithshme, lidhur me nenin 22 par 1.6 të Ligjit për Gjykatat parashtrajmë këtë:

ANKESË

(lidhur me cënimin e të drejtës në gjykim të drejtë dhe të paanshëm)

Sepse me dt 13.10.2017. në orën 16:40 kemi pranuar vendimin ZL.Anr 171/2017, të PZAP-së më të cilin Lëvizja Vetëvendosje, Qendra, në Lipjan është dënuar me gjobë në vlerë prej 550.00 euro, për shkak të vendosjes së një tavoline me material zgjedhor me foto dhe logo të LVV-së në rrugën "Lidhja e Prizrenit" edhe pse vendosjen kësaj tavoline, Lëvizja Vetëvendosje ka marrë pëlqim paraprak nga Komuna e Lipjanit në lidhje me vendosjen e këtij materiali zgjedhor. Në lidhje me këtë, PZAP, në arsyetimin e vendimit të vetë pranon që Lëvizja Vetëvendosje, Qendra në Lipjan ka marrë leje ose "Pëlqim" nga Komuna përkatëse lidhur me vendosjen e materialit zgjedhorë në rrugën Lidhja e Prizrenit, nga dt 04.10.2017 deri më 19.10.2017, mirëpo këto veprime sipas Panelit janë në kundërshtim me ligjin e zgjedhjeve, konkretisht sipas nenit 33 par pika b) ku theksohet se "vendosja e njoftimeve, pllakateve dhe posterëve, ose përndryshe, vendosja e emrave të tyre ose e sloganeve në lidhje me fushatën zgjedhore brenda ose jashtë ndërtesave publike ose godinave, në apo mbi rrugët publike, në shenjat publike të trafikut, brenda ose jashtë hapësirave ose ndërtesave të zëna ose, ndryshe, që shfrytëzohen nga organizatat ndërkombëtare, ose brenda ose në hapësirat private pa lejen e pronarëve ose shfrytëzuesve". Andaj, sipas Panelit edhe PËLQIMI i dhënë nga komuna përkatëse është në kundërshtim me LZP-në, gjegjësisht me nenin, 33 par 1 pika b.

Provë: Vendimi ZL.Anr 171/2017, PZAP-së

Në lidhje me këtë, 02. 10 2017, PZAP ka pranuar një ankesë nga subjekti politik "Alternativa" kundër Lëvizjes Vetëvendosje, qendra në Gjakovë, me të cilin pretendon se Lëvizja Vetëvendosje, Qendra në Gjakovë, ka vendosur pano reklamuese të kandidatit për kryetar të komunës së Gjakovës, nga radhët e Lëvizjes Vetëvendosje, Driton Çaushtit në objektin banesor për të cilin subjekti politik Alternativa ka marrë pëlqim nga Komuna e Gjakovës. Mirëpo ankesa në fjalë është refuzuar si e pa bazuar për shkak se Lëvizja Vetëvendosje, qendra në Gjakovë, ka pasur marrëveshje me një kompani private për vendosjen e panove në objekte banesore të tilla, e cila kompani ka marrë pëlqim nga komuna e Gjakovës për

reklamim të tillë. Paneli i PZAP-së me dt 06.10.2017 vlerësoi se Refuzohet si e pabazuar ankesa e subjektit politik në fjalë për faktin se këto veprime të LVV-së , Qendra në Gjakovë nuk përbëjnë shkelje sipas nenit 33 par 1 pika b për shkak se kompania në fjalë ka marrë pëlqim nga komuna para se subjekti politik Alternativa të bëjë kërkesë në komunën e Gjakovës duke theksuar se vendosja e panove reklamuese është vend i dedikuar për vendosjen e posterit. Sipas kësaj, veprimi është i lejuar sipas nenit 33 par 1 pika b nese një **poster apo pano** vendoset përmbi rrugë dhe me leje nga Komuna.

Provë: vendimi ZLA.nr 117/2017, dhe ankesa subjektit politik alternativa me fotografi të bashkëlidhura.

Rasti tjetër i të njëjtës natyrë ka ndodhur në Pejë, ku Lidhja Demokratike e Kosovës me dt 05.10.2017 ka bërë ankesë kundër Lëvizjes Vetëvendosje në Pejë, për shkak të posterva të vendosura në shtyll të ndriqimit publik, edhe në këtë rast Paneli vendosi që që ta refuzoj ankesën e subjektit politik të lartcekur me pretendimin se për një gjë të tillë kompania në fjalë ka marrë leje nga Komuna dhe vendosja e posterave në shtylla elektrike të ndriqimit public është vendi dedikuar për vendosjen e posterave gjë që nuk përbën shkelje të nenit 33 par 1 pika b). Kurse, në po këtë nen theksohet se vendosja e posterave në shtylla elektrike është e ndaluar dhe konsiderohet mbi rrugë publike. Miëpo leja e komunës përkatëse bënë veprim të lejushum..

Provë: ZL.Anr 127/2017, si dhe ankesa e LDK-së me fotografi të bashkëlidhura.

Në lidhje me këtë shkelja e praktikës gjyqësore nga vetë paneli i PZAP-së paraqet një absurditet të një natyre të veçantë i cili ka cënuar parimin e të drejtës në gjykim të drejtë dhe të paanshëm në rastin e nxjerrjes së këtij vendimi si dhe cënimin e Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut, konkretisht nenin 6). Kushtetuta e Kosovës në nenin 31 pëcakton këtë parim si garanci për mbrojtjen e e të drejtave dh lirive të njeriut lidhur me një gjykim fer dhe të drejtë, korrekt dhe i paanshëm. Përveq kësaj, pavarësia dhe paanësia e gjykatës përkufizohet edhe në nenin 102 par par 2 i Kushtetutës së Kosovës. Në lidhje me këtë, konstatohet së përmes shkeljes së praktikës së vetë gjyqësore nga PZAP , lidhur vendimin ZL.Anr.171/2017, PZAP ka shkelur në menyrë flagrante nenin 31 të Kushtetutës dhe nenin 6 të Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive të Njeriut, me të cilin garantohej një gjykim fer i paanshëm dhe i drejtë. PZAP ne mes vendimeve të nxjerrura më heret dhe vendimit kontestues është mbështetur në dipozitën e njëjtë duke e interpretuar atë në menyra të ndryshme me të cilin ka rezultuar me një gjykim jo të drejtë të anëshëm dhe jokorret. Gjykimi jo i drejtë , anëshëm dhe jo korrekt ka rezultuar nga shkelja e praktikës gjyqësore me të cilin si pasojë e kësaj, Lëvizjes Vetëvendosje po ju cenohet e drejta e bërjes së fushatës duke u gjobitur pa të drejtë, për shkak respektimit aktëve komunale të lëshuara nga komuna përkatëse. Lëvizja Vetëvendosje nuk ka bërë asgjë tjetër përveq se ka respektuar vendimin e Komunës përkatëse për vendosjen e një tavoline dhe në rrugë publike me të cilin ju ka lejuar në vendimin përshkruar më lartë. Rruga publike në këtë rast konsiderohet rrugë e cila është në pronsi të komunës përkatëse dhe për të cilin sipas kompetencave të saj mund të jap leje të veqant një personi juridik apo fizik për shfrytëzimin e saj. Në lidhje me këtë komuna gjatë dhënjës se lejës është bazuar në Ligjin për Ndërtimin, duke respektuar nenin 5.1.7 me të cilin përcaktohet dhënja e lejeve për ngritjen e objekteve të përkohshme . Përveq kësaj, PZAP nuk ka kompetencë ligjore të bëjë vlerësimin e akteve nënligjore të Komunsë përkatëse . Komuna aktet e veta i nxjerr duke ushtruar kompetencat e veta në kuptim të dipozitave të Ligjit për Qeverisjen e Lokale dhe në bazë të statutit të saj. Pra, vlerësimin e

akteve nënligjore të komunave dhe kundërshtimin e tyre me me ligjin , mundë ta bëjë vetëm Ministria përkatëse dhe gjykatat e tjera sipas Ligjit për gjykatat.

Ndër tjera, vendimi i kontestuar i PZAP-së ka cënuar edhe ligjin mbi zgjedhjet respektivisht nenin 44 par 1 pika a dhe b lidhur me nenin 2 dhe 3 par 3.3 të rregullës zgjedhore 2013/13. Kjo rregull në asnjë nen të saj nuk thotë që materialet e tilla nuk mund të vendosen në hapsira publike, përkundrazi përcakton se materialet zgjedhore mund të përcaktohen në vendet me të frekuentuara dhe me të dukshme në komunë.

Vendimi ZL.Anr 171/2017 përveq shkeljeve ligjore dhe nënligjore ka prekur/cënuar edhe Kushtetutën e Kosovës nenin 31 dhe Konventën Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive të Njeriut, konkretisht nenin 6. Andaj PZAP, në lidhje me këtë rastë ka vepruar në menyrë të padrejtë anshëm jo korrekt dhe jofer ,duke cënuar hirarkinë e një sër normash juridike.

Andaj , duke u bazuar në referatin e ankesës dhe provave të bashkangjitur PROPOZOJMË që Gjykata Supreme të merrë këtë

A K T G J Y K I M

I . Të hedhet poshtë VEDNDIMI ZL.An 171/2017 të PZAP-së, dhe,

II. Të vendoset në tërsi sipas referatit të Ankesës.

Vërejtje

Të bashkangjitur keni vendimet dhe ankesat në cilësi të provës materiale.

Lëvizja Vetëvendosje

Përfaqësuar nga:

Dt. 14.10.2017

Blerim SALLAHU

